


Irlandë



An Roinn Dlí agus Cirt,
Gnóthaí Baile agus Imirce
Department of Justice,
Home Affairs and Migration



ÇFARË DUHET TË DINI RRETH EURODAC



ALBANIAN

➤ PËRSE PO E MARR KËTË BROSHURË?

Po e merrni këtë broshurë për shkak se autoritetet duhet të mbledhin të dhënat tuaja biometrike



Të dhënat biometrike nënkuptojnë gjurmët e gishtave dhe fotografinë tuaj.



Këto të dhëna do të transmetohen te baza e të dhënave Eurodac së bashku me informacionin rreth identitetit tuaj dhe informacione të tjera përkatëse.

Në këtë broshurë shpjegohen të drejtat tuaja gjatë këtij procesi dhe çfarë pritet nga ju.

➤ ÇFARË ËSHTË EURODAC?

Eurodac është një bazë të dhënash evropiane që ruan dhe krahason informacionin rreth kategorive të caktuara të personave që hyjnë në vendet e BE+. Këto kategori shpjegohen hollësisht në këtë broshurë.

Kjo bazë të dhënash përdoret nga 31 vende të BE+ që mund t'i përpunojnë të dhënat tuaja dhe të marrin informacione rreth jush. Në rast se ju udhëtoni pa leje në një vend tjetër të BE+ dhe ju merren sërish të dhënat tuaja, atëherë të gjitha të dhënat tuaja që ruhen në Eurodac do të aksesohen nga autoritetet e atij vendi. Në disa raste, të dhënat tuaja do të përditësohen me informacione të reja.

➤ CILAT JANË VENDET E BE+?

Aktualisht ndodheni në Irlandë i cili është një vend i BE+.

Vendet e BE+ janë:



27 shtetet anëtare të Bashkimit Evropian (BE): Austria, Belgjika, Bullgaria, Kroacia, Qiproja, Çekia, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Hungaria, Italia, Letonia, Lituania, Luksemburgu, Malta, Holanda, Polonia, Portugalia, Republika e Irlandës, Rumania, Sllovakia, Sllovenia, Spanja, Suedia dhe



4 vende të tjera: Islanda, Lihtenshtajni, Norvegjia, Zvicra.

➤ CILI ËSHTË OBJEKTIVI I EURODAC?

Eurodac ka pesë objektiva kryesorë:

- ✔ të ndihmojë vendet e BE+ që të përcaktojnë vendin përgjegjës për shqyrtimin e një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare
- ✔ të ndihmojë në monitorimin e migracionit të rregullt dhe të parregullt në vendet e BE+
- ✔ të ndajë informacione mes autoriteteve kombëtare dhe të parandalojë krimin dhe terrorizmin
- ✔ të sigurojë gjurmimin dhe mbrojtjen e fëmijëve që mbërrijnë në Evropë
- ✔ të sigurojë funksionimin e duhur të bazave të tjera të të dhënave evropiane që përmbajnë informacion rreth aspekteve të ndryshme, si p.sh. vizat.



➤ TË DHËNAT E KUJT RUHEN NË EURODAC?

Eurodac përmban të dhëna rreth personave që nuk janë shtetas të një vendi të BE+, të cilët:

- ✔ paraqesin kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare
- ✔ kalojnë pa leje kufirin e një vendi të BE+
- ✔ kanë zbarkuar në një vend të BE+ pasi janë shpëtuar në det
- ✔ qëndrojnë në mënyrë të paligjshme në një vend të BE+
- ✔ kanë mbërritur në një vend të BE+ përmes programit të BE-së lidhur me risistemimin ose pranimin për motive humanitare, ose përmes një programi kombëtar të risistemimit
- ✔ kanë përfituar mbrojtje të përkohshme.

➤ KUSH MUND T'I SHOHË TË DHËNAT E MIA?

Autoritetet kombëtare të azilit në vendin e BE+ do të marrin të dhënat tuaja biometrike dhe do t'i transmetojnë ato tek Eurodac së bashku me të dhënat e tjera përkatëse dhe do të marrin rezultatet e krahasimit.

Agjencia e Bashkimit Evropian për Bashkëpunim në Zbatimin e Ligjit dhe policia kombëtare mund të kërkojnë akses në Eurodac me qëllim parandalimin, zbulimin dhe hetimin e krimeve të rënda dhe terrorizmit. Ato mund të kërkojnë të dhënat tuaja në Eurodac.

⚠ E RËNDËSISHME! Autoritetet në vendin tuaj të origjinës nuk do të mund ta aksesojnë këtë informacion.

➤ ÇFARË NDODH NËSE REFUZOJ TË JAP GJURMËT E GISHTAVE?



Ju jeni të detyruar me ligj që të jepni të dhënat tuaja biometrike.

Ka arsye të rëndësishme se përse nevojiten gjurmët tuaja të gishtave. Ky është një hap i nevojshëm në këtë procedurë në rast se keni paraqitur kërkesë për azil.

Të dhënat e gjurmëve të gishtave mund të ndihmojnë gjithashtu në gjetjen e anëtarëve të familjes që ndodhen në vendet e BE+.

Nëse gjurmët tuaja të gishtave janë të dëmtuara, atëherë ato do të merren sërish më vonë.

Ju do të përballeni me pasoja negative në rast se dëmtoni qëllimisht gjurmët tuaja të gishtave.

Për shembull, procedura mund të ndërpritet në rastet kur keni paraqitur kërkesë për azil.

Nëse procedura ndërpritet në rastin tuaj, atëherë kjo nënkupton se nuk do të konsideroheni më si kërkues (azilkërkues). Nga ky moment e tutje, ju do të humbisni çdo të drejtë që lidhet me atë status.

Autoritetet e vendeve të BE+ mund të përdorin shtrëngimin si masë e fundit për të marrë të dhënat tuaja biometrike. Gjithashtu, ato mund t'ju ndalojnë si masë e fundit për të përcaktuar ose verifikuar identitetin tuaj.

Do të përballeni me pasoja specifike në rast se refuzoni t'u jepni të dhënat e gjurmëve të gishtave autoriteteve në këtë vend.

Refuzimi për t'u dhënë të dhënat e gjurmëve të gishtërinjve autoriteteve në këtë vend është një bazë për Zyrën e Mbrojtjes Ndërkombëtare që të tërheqë në mënyrë implicite kërkesën tuaj për mbrojtje ndërkombëtare.

CILAT JANË TË DREJTAT E MIA LIDHUR ME TË DHËNAT PERSONALE NË EURODAC?

Çdo vend i BE+ ka një autoritet që kontrollon përdorimin e të dhënave. Ju keni të drejtën të kontaktoni kontrolluesin e të dhënave dhe nëpunësin për mbrojtjen e të dhënave dhe të kërkonit akses në të dhënat tuaja që janë ruajtur në Eurodac.

Mund të kërkonit korrigjimin e informacionit tuaj, nëse besoni se ky i fundit:

- është i pasaktë dhe ka nevojë për korrigjim
- është i paplotë dhe ka nevojë për përditësim

Mund të kërkonit fshirjen e informacionit tuaj, nëse besoni se ky i fundit:

- është futur në Eurodac në mënyrë të paligjshme.

Të dhënat e kontaktit të kontrolluesit të të dhënave dhe nëpunësit për mbrojtjen e të dhënave mund t'i gjeni në faqen e fundit të kësaj broshure, me titull "**Informacione të tjera të dobishme**".

Nëse dëshironi të paraqisni një ankesë zyrtare për sa i përket trajtimit të të dhënave tuaja, mund të kontaktoni autoritetin mbikëqyrës kombëtar.

Të dhënat e kontaktit të autoritetit mbikëqyrës kombëtar mund t'i gjeni në faqen e fundit të kësaj broshure.

INFORMACIONE TË TJERA TË DOBISHME

INFORMACION MBI TË DHËNAT E KONTAKTIT TË ZYRËS SË KONTROLLUESIT TË TË DHËNAVE

Më poshtë, mund të gjeni informacion mbi mënyrën se si të kontaktoni zyrën e kontrolluesit të të dhënave dhe nëpunësit për mbrojtjen e të dhënave në këtë vend.

Kontrolluesi i të dhënave mund t'ju informojë për atë pjesë të të dhënave personale që është ruajtur në Eurodac. Nëse të dhënat tuaja personale nuk janë ruajtur në mënyrë të saktë, atëherë mund të kërkonit korrigjimin e këtyre të dhënave.

Nëse besoni se ndonjë informacion i juaji është trajtuar në mënyrë të paligjshme, mund të kërkonit që ky informacion të fshihet duke përdorur informacionin e kontaktit më poshtë.

Të dhënat e kontaktit të kontrolluesit të të dhënave janë: International Protection Office, Immigration Service Delivery, 79-83 Lower Mount Street, Dublin 2, D02 ND99 or contact@ipo.gov.ie

INFORMACION MBI TË DREJTAT E SUBJEKTIT TË TË DHËNAVE

Në këtë vend, ju keni të drejtat specifike të mëposhtme lidhur me përdorimin e të dhënave tuaja personale.

Detajet në lidhje me të drejtat tuaja të mbrojtjes së të dhënave mund të gjenden në Politikën e Mbrojtjes së të Dhënave të Departamentit të Drejtësisë, Punëve të Brendshme dhe Migracionit, të disponueshme në <https://assets.gov.ie/static/documents/departament-of-justice-data-protection-policy.pdf>. Mund të kontaktoni Zyrtarin e Mbrojtjes së të Dhënave për Departamentin e Drejtësisë, Punëve të Brendshme dhe Migracionit me email në: dataprotectioncompliance@justice.ie

INFORMACION MBI TË DHËNAT E KONTAKTIT TË AUTORITETEVE MBIKËQYRËSE KOMBËTARE

Mund të përdorni informacionin e mëposhtëm për të kontaktuar autoritetin mbikëqyrës kombëtar në këtë vend.

Mund të paraqisni një ankesë zyrtare drejtuar autoritetit mbikëqyrës kombëtar nëse besoni se ndonjë pjesë e të dhënave tuaja personale është trajtuar në mënyrë të paligjshme.

Të dhënat e kontaktit të Komisionit të Mbrojtjes së të Dhënave janë: 6 Pembroke Row, Dublin 2, D02 X963 ose mund t'i kontaktoni ata në internet në <https://forms.dataprotection.ie/contact>



An Roinn Dlí agus Cirt,
Gnóthaí Baile agus Imirce
Department of Justice,
Home Affairs and Migration

Kjo broshurë shërben vetëm për qëllime informuese. Ajo nuk krijon në vetvete të drejta apo detyrime. Agjencia e Bashkimit Evropian për Azilin (EUAA) ka siguruar strukturën kryesore të këtij materiali dhe riprodhimi dhe ndryshimi i kësaj broshure autorizohet nga EUAA-ja vetëm për shtetet anëtare të BE-së. EUAA-ja nuk merr përsipër asnjë përgjegjësi apo detyrim për saktësinë, përmbajtjen, plotësinë, ligjshmërinë ose besueshmërinë e informacionit të përfshirë në këtë broshurë nga shtetet anëtare të BE-së ose nga ndonjë palë tjetër e tretë përgjegjëse. EUAA-ja dhe çdokush që vepron në emër të EUAA-së nuk mbajnë përgjegjësi për përdorimin që mund t'u bëhet informacioneve që përmban kjo broshurë.